

FLETËNOTIM

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VII - XII / 2011



 **KDI**
Instituti Demokratik i Kosovës
Kosova Democratic Institute
www.kdi-kosova.org

Janar 2012

PERSONELI

Ismet KRYEZIU - Drejtor Ekzekutiv
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës dhe financave
email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për administratë dhe financa
email: lcikaj@kdi-kosova.org

Arsim Gjinovci - IT & Design
email: agjinovci@kdi-kosova.org

PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE PRAKTIKAT PARLAMENTARE

Driton SELMANAJ - Menaxher i programit
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Halil MATOSHI - Analist
email: hmatoshi@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Analist
email: izejna@kdi-kosova.org

Shkumbin BEQIRI - Vëzhgues i Parlamentit
email: shbeqiri@kdi-kosova.org

Floriqe MEHMETI - Vëzhguese e Parlamentit
email: fmehmeti@kdi-kosova.org

PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Kreshnik BASHA - Koordinator
email: kbasha@kdi-kosova.org

Naim CAHANAJ - Koordinator
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI: TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - Menagjere e programit
email: mmustafa@kdi-kosova.org

Kujtim BYTYQI - Kryesues i hulumtimeve
email: kbytyqi@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Koordinator i projektit
email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Enis XHEMAI - Asistent i projektit
email: exhemai@kdi-kosova.org

Donjeta DRESHAJ - Asistente për administratë dhe financa
email: ddreshaj@kdi-kosova.org

Natyra KASUMAJ - Koordinatore
email: nkasumaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA

Liridon SELMANI - Menaxher i programit
email: lselmani@kdi-kosova.org

NOTIMI

Vlerësimet e paraqitura në këtë fletënotim janë të bazuara në monitorimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare, mbledhjeve të komisioneve parlamentare, materialeve të publikuara në faqen elektronike të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bisedat e drejtpërdrejta me deputetët si dhe personelin mbështetës të Kuvendit. Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe subjektet politike janë notuar në mënyrë individuale në kategori të caktuara të cilat reflektojnë performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

KATEGORITË

KDI në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe subjekteve politike në kategoritë të paraqitura në vijim:

1. Pjesëmarrja në diskutim;
2. Pjesëmarrja në diskutim në emër të Grupit Parlamentar;
3. Ngritja e çështjeve apo propozimeve;
4. Ngritja e çështjeve apo propozimeve urgjente;
5. Propozimet për amendamente;
6. Nismat legislative;
7. Kërkesat për interpelancë;
8. Pyetjet parlamentare;

SHTYLLAT E ANALIZËS

Aspekti i përgjithshëm i punës së Kuvendit është vlerësuar në bazë të shtyllave të paraqitura në vijim:

- Seancat plenare;
- Komisionet parlamentare;
- Kontrolli parlamentar ndaj qeverisë;
- Implementimi i Planit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2011

PËRMBAJTJA

• Kuvendi i Kosovës	5
• Seancat plenare	5
• Çështjet që e sfiduan Kuvendin e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese	6
• Komisionet parlamentare	8
• Mbledhjet e Komisioneve parlamentare	8
• Dëgjimet Publike	10
• Monitorimi i Zbatimit të Ligjeve	10
• Mbikëqyrja parlamentare	11
• Interpelancat parlamentare	11
• Realizimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2011	12
• Parregullsitë që po e shoqërojnë punën e Kuvendit	14

KUVENDI I KOSOVËS

Në shtetet dhe sistemet demokratike pushteti i vërtet buron nga vota e lirë e qytetarëve. Përfaqësuesit e zgjedhur janë ata të cilët ushtrojnë pushtetin legjislativ.

Detyra kryesore e tyre është të vendosin drejtimin politik të shtetit nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve (funksioni legjislativ), mbikëqyrjen parlamentare të qeverisë (funksioni mbikëqyrës) si dhe rolin fundamental atë të përfaqësimit të interesave të qytetarëve (funksionin përfaqësues). Për arsyen se Kuvendi është organi që legjitimohet nga vullneti i popullit, nëpërmjet zgjedhjeve, ai gëzon një pozitë të fortë në sistemin politik shtetëror dhe kjo shprehet qartë në Kushtetutën e Kosovës,

Brenda një legjislature, veprimtaria parlamentare organizohet në sesione plenare.

Sesioni përcakton periudhën e vitit gjatë së cilës, parlamenti zhvillon punimet. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 69) përcaktohet që Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione. Sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar, kurse sesioni vjeshtor fillon të hënën e dytë të muajit shtator.

Në këtë fletënotim janë përfshirë të dhënat që vlerësojnë punën e Kuvendit të Kosovës në periudhën kohore korrik-dhjetor 2011, që do të thotë se përfshinë pjesërisht sesionin pranveror dhe plotësisht atë vjeshtor.

SEANCA PLENARE

Periudha raportuese, korrik-dhjetor 2011 është karakterizuar me një dinamikë mjaft të lartë të punës në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku në total janë mbajtur 24 seanca plenare, prej tyre 20 të rregullta, 2 të jashtëzakonshme dhe 2 solemne.

Edhe në këtë gjashtëmujor të vitit 2011, çështja e veriut të Kosovës si dhe masat e reciprocitetit me Serbinë kanë qenë ndër çështjet më të rëndësishme që i ka trajtuar Kuvendi i Kosovës në Seanca plenare. Për problemin e veriut, me kërkesë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Kuvendi me 27 tetor kishte ftuar Kryeministrin e Kosovës Hashim Thaçi, për të raportuar lidhur me situatën politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Ndërsa lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë po ashtu me kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", u ftua në interpelancë ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari-Lila, në seancën e 07.12.2012.

Muajt e parë të këtij gjashtë mujori janë karakterizuar me një numër të madh të projektligjeve të miratuara për shkak të afrimit të publikimit të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian.

Me t'u afruar data e publikimit të Raportit të Progresit, i nxitur edhe nga Qeveria e cila procedoi një numër të madh të ligjeve, Kuvendi madje vetëm në një seancë ka miratuar më shumë ligje në leximin e dytë sesa në pesë muajt e parë të punës së vet.

Kjo ka ndikuar edhe në rritjen e dinamikës së punës së Kuvendit dhe trupave të tij, pasi që për më pak se 8 ditë pune trupat e Kuvendit kanë mbajtur 28 mbledhje të komisioneve dhe 5 ditë seanca plenare. Ajo që është shqetësuese për këtë formë të punës, është fakti se vetëm afrimi i datës së publikimit të këtij raporti, arriti ta mobilizojë Kuvendin e Kosovës që të filloi seriozisht të merret me shqyrtimin e projektligjeve, por procedimi i shpejtë i tyre rrezikon kualitetin e projektligjeve dhe me këtë edhe i bën vështirë të zbatueshëm në praktikë.

Çështje tjera që kanë ngjallur debat të nxehtë në Kuvendin e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë: Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit, Projektligji për Hoqën

e Madhe, Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, të Invalidëve, të Veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të Familjeve të tyre; Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 etj.

ÇËSHTJET QË E SFIDUAN KUVENDIN E KOSOVËS GJATË KËSAJ PERIUDHE RAPORTUESE

I. Mocioni i Kuvendit të Kosovës për masa reciprociteti me Republikën e Serbisë

Me 7 dhjetor 2011 Kuvendi i Kosovës miratoi Mocionin për masat e reciprocitetit të plotë me Serbinë të ngritur nga Lëvizja Vetëvendosje, të vendosura më 20 korrik 2011, me 42 vota për, 33 ishin kundër ndërkaq 2 deputetë abstenuan. Ky ishte një prej rasteve të rralla kur opozita ia del të sigurojë shumicën e thjeshtë në Kuvend për ta shndërruar një nismë në vendim. Natyrisht se ky vendim si çdo akt tjetër i Kuvendit duhej të konsiderohej si obligues për Qeverinë, mirëpo shefi i ekzekutivit (Kryeministri) e cilësoi si këshillëdhënës, madje i vonuar, për ta bërë të ditur se ishte vetëm “një letër e vdekur”.

Derisa autoritetet qeveritare pohonin se mocioni i Lëvizjes VV për rikthimin e masave të reciprocitetit me Serbinë, është duke u zbatuar, dhe se Kosova tashmë ishte në raport reciprociteti me Republikën e Serbisë, por ndryshe mendonin subjektet politike opozitare si dhe Doganat e Kosovës.

Për zyrtarët e ICO-së, Kuvendi ka të drejta dhe detyrime kushtetuese përkitazi me monitorimin e Qeverisë së Kosovës, dhe ngarkohet sipas Kushtetutës me ratifikimin e marrëveshjeve të caktuara, kurse përgjegjësia për të hyrë në marrëdhënie bilaterale dhe multilaterale me vende të tjera i mbetet Qeverisë së Kosovës dhe Presidencës. Sipas shefit të ICO-së, Piter Feith mocioni i votuar në Kuvend nuk ka efekt detyrues për qeverinë pasi politikën e jashtme e bën ekzekutivi dhe jo legjislativi, por ai as nuk e ka shfuqizuar vendimin e Kuvendit.

Nga ana tjetër për fuqinë që ka ky mocion dhe obligimin që e ka Qeveria ta zbatojë atë, kryeparlamentari i Kosovës Jakup Krasniqi, kishte një përgjigje të paqartë duke u thirr në Kushtetutën si dokument bazë, por ai nuk ishte decidiv rreth faktit se a e detyron ky vendim Qeverinë që ta zbatojë apo është vetëm një opinion.

Duhet pranuar faktin se qasjet e tilla ndikuan në rritjen e paqartësisë së situatës politike në vend si dhe patën ndikim në zvogëlimin e mundësive për gjetjen e alternativave për dalje nga situata e krijuar.

Miratimi i këtij mocioni dhe ngjarjet që pasuan më pas, mund të nxjerrin konkluzionin se ky aprovim mund të ketë qenë me emotivitet, pra pa u menduar reperkusionet dhe implikimet e mundshme politike. Sepse tash, kur Lëvizja VV kërkon zbatimin e tij të plotë, as vet kreu i Kuvendit dhe as shumica e deputetëve nuk kanë një qëndrim të prerë, nëse ky mocion ishte detyrues për Qeverinë ose jo.

Paqartësitë dhe tendencat eventuale nga të gjitha institucionet po e vënë në pikëpyetje të madhe pavarësinë dhe integritetin e pushteteve në Kosovë si element crucial për ndërtimin e shtetit demokratik.

Normat kushtetuese Kuvendin e përcaktojnë si institucionin më të lartë Ligjvënës të Republikës dhe asesi si një trup Këshillëdhënës.

II. Rregullorja për qasjen e mediave në Kuvendin e Kosovës rritë jo transparencën

Rregullorja për qasjen e mediave në Kuvendin e Kosovës, e cila ka filluar të zbatohet që nga 10 dhjetori 2011 ndryshoi protokollin e pranisë së përfaqësuesve të mediave në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës. Sipas kësaj Rregulloreje, përfaqësuesit e mediave do të vendosen në këndin për gazetarë nga ku nuk mund të lëvizin, pa leje, nëpër ndërtesën e Kuvendit, ndërsa seanca për fotografim dhe xhirim të pamjeve zgjat pesë minuta. Më tutje sipas këtij vendimi një punonjës i Zyrës për media dhe marrëdhënie me publikun do të kujdestarohet në këndin për gazetarë si ndërlidhës ndërmjet përfaqësuesve të mediave dhe deputetëve.

Në anën tjetër të shqetësuar me hyrjen në fuqi të rregullores për qasjen e mediave në Kuvendin e Kosovës, Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK) u ka bërë thirrje me 21 dhjetor 2011 të gjithë anëtarëve të vet, gazetarëve dhe mediave të vendit që të bojkotojnë punën e Parlamentit të Kosovës. Kjo rregullore është miratuar në Kryesinë e Kuvendit, nga të gjitha subjektet politike parlamentare dhe si e tillë – sipas AGPK – tregon se ato nuk janë të interesuara për të krijuar kushte për punën e gazetarëve. Përmbajtja e këtij dokumenti, sipas AGPK, është hartuar pa e marrë parasysh vullnetin e gazetarëve dhe kontributet e tyre në disa punëtori gjatë hartimit të rregullores.

Më 23 dhjetor 2011 Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi ka këmbëngulur se Rregullorja për qasjen e mediave në Kuvend është shumë e mirë, por sipas tij, ajo është keqkuptuar. Krasniqi është arsyetuar se nuk ka qenë i informuar për ndalesat që u janë bërë gazetarëve dy ditë më parë, duke mos i lënë të hynë te hollit i Kuvendit. Sipas tij me këtë rregullore, gazetarëve vetëm u ndalohej që të xhirojnë dhe fotografojnë në holl, restorant dhe në mbledhjet e mbyllura të komisioneve.

Krasniqi ka sqaruar se rregullorja nuk ndalon qasjen e mediave, të publikut dhe të shoqërisë civile në Kuvend, dhe se ajo nuk ka qenë lëndë e komisioneve dhe organeve tjera, përveç e Kryesisë dhe administratës, gazetarëve, OSBE-së dhe NDI-së. Rregullores i është shtuar nga Kryesia e Kuvendit, në rregullën e 10, pika 7 ndalimi i fotografimit dhe incizimit në restorantin e Kuvendit, në holl dhe në mbledhjet e mbyllura.

Hapësira aktuale që u është ndarë gazetarëve, sipas Krasniqit, është e përkohshme, kurse në të ardhmen e afërt, Kryetari i Kuvendit ka thënë se do të krijohet hapësira e mjaftueshme prapa sallës së Kuvendit, ndërsa gazetarët do të kenë qasje direkte edhe në seancat plenare. Me fillimin e zbatimit të Rregullores së re për qasjen e mediave në Kuvend, gazetarët janë përballur me ndalesa të rrepta të qasjes në ambientet e Kuvendit, përveç “Këndit të gazetarëve”, në hyrje të Kuvendit, hapësirë që nuk i plotëson as për së afërmi kushtet për ndjekjen e seancave plenare, apo kryerjes së aktiviteteve tjera të mediave në Kuvend.

Kufizimet që u janë bërë mediave në Kuvend e sforcon më shumë jo transparencën dhe duke aprovuar kufizime të reja ndaj medias dhe shtypit, kjo do të pasqyrohet si prapaktim në Raportin e Progresit sa i përket lirisë së mediave.

Vet emërtimi “Këndi i mediave” është kufizim i lirisë së mediave, po ashtu një hapësirë prej rreth 40 metrave katrorë, ndodhet afër recepcionit në hyrje të Kuvendit, ku lëvizjet e punëtorëve të administratës dhe vizitorëve, janë të mëdha, gjë që e bën të pamundur ndjekjen e seancave. Ky kënd është i paraparë edhe për konferenca të ndryshme, gjë që e pamundëson zhvillimin e dy aktiviteteve njëherësh, ndjekja e seancës dhe konferenca për media, në të njëjtën kohë.

Ky veprim i Kuvendit të Kosovës është një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e përditshme të gazetarëve që raportojnë nga seancat e legjislativit.

Lejimi i gazetarëve që në seancë të qëndrojnë vetëm 15 minuta është kufizues, kurse mundësia që ata të mund të marrin “materiale” shtesë është e vogël, pra gazetarët duhet të ballafaqohen me masa burokratike. Paradoksale është fakti se në këso rastesh (për materiale shtesë, deklarata deputetësh dhe konfirmime të lajmeve etj.) gazetari duhet t’i bëjë një kërkesë Zyrës për media, e pastaj ajo kërkon pajtimin e sekretarit të Kuvendit... Gazetarët në Kosovë në disa raste janë ankuar në lidhje me transparencën e institucioneve, por kjo ishte hera e parë që ata vendosën edhe të bojkotojnë me të drejtë punën e një institucioni.

Sidoqoftë, përkundër një marrëveshje të përkohshme mes gazetarëve dhe Kuvendit të Kosovës tejkalimi i mosmarrëveshjeve, duket të mos jetë ende përfundimtar, pasi që Kryesia ende nuk u ka dhënë të drejtën mediave që të xhirojnë në hollin e Kuvendit. Rregullorja e re nuk i plotëson standardet demokratike dhe nuk siguron kushte të volitshme për qasje të lirë të mediave në punën e legjislativit.

KOMISIONET PARLAMENTARE

Në praktikën parlamentare demokratike, komisionet parlamentare si mekanizma qenësorë në kuadër të parlamenteve, kryejnë funksione shumë të rëndësishme në procesin legjislativ, në kontrollin e pushtetit ekzekutiv si dhe në transparencën e qeverisjes dhe të proceseve tjera politike. Funksionet e komisioneve bazën legale e kanë në aktin më të lartë juridik dhe politik të vendit – Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren e Kuvendit, duke shqyrtuar dhe amendamentuar projektligje si dhe duke monitoruar zbatimin e ligjeve. Përveç tjerash, merren edhe me përgatitjen e rekomandimeve për vendimet përfundimtare të Kuvendit dhe raportimin për çështjet që dalin nga fushë – veprimtaria e tyre që u referohen.

Për dallim nga legjislatura e III-të, kjo legjislaturë ka zvogëluar numrin e komisioneve me gjithsejtë 13, katër (4) nga të cilët janë të përhershme, nëntë (9) janë komisione funksionale si dhe është themeluar edhe një (1) nën-komision (Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës) i cili funksionon në kuadër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi.

Gjatë vitit të parë të kësaj legjislature Kuvendi i Kosovës ka themeluar po ashtu edhe dy komisione ad-hoc: Komisionin për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Komisionin për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

MBLEDHJET E KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Varësisht prej natyrës së fushë-veprimtarisë që mbulojnë komisionet parlamentare, kjo në një mënyrë determinon edhe dinamikën e punës së tyre duke i’u përkushtuar planeve dhe aktiviteteve të tyre për secilin vit.

Dinamika e punës së komisioneve parlamentare në periudhën korrik-dhjetor 2011, është rritur dukshëm në krahasim me sesionin pranveror të Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2011.

Periudha korrik – dhjetor rezulton me 252 mbledhje të mbajtura nga komisionet parlamentare (21 prej tyre dëgjime publike) ndërkaq në periudhën paraprake mars-qershor ishin mbajtur 157 takime të komisioneve. Komisioni me numrin më të madh të mbledhjeve edhe në këtë periudhë raportuese është Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri me gjithsejtë 27 mbledhje të mbajtura. Pas tij radhiten Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor me 25 takime si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa me 24 takime të realizuara. Ndërsa, komisioni me më së paku mbledhje të mbajtura gjatë kësaj periudhe raportuese është Komisioni për Punë të Jashtme me vetëm 8 takime të mbajtura.

Komisionet parlamentare	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
1. Komisioni për Buxhet dhe Financa	4	4	4	3	6	3	24
2. Komisioni për te drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim	5	2	3	3	1	3	17
3. Komisioni për Legjislacion	5	3	3	2	2	4	19
4. Komisioni për Integrimi Evropiane	3	3	3	4	2	3	18
5. Komisioni për Punë të Jashtme	2	0	2	2	2	0	8
6. Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	3	5	3	2	4	3	20
7. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri	6	3	7	3	5	3	27
8. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	3	0	1	3	5	1	13
9. Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor	4	2	4	4	7	4	25
10. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës	3	2	4	1	4	3	17
11. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë	2	0	3	2	2	1	10
12. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	5	2	3	3	4	2	19
13. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	3	2	3	3	2	1	14

Tab.1. Numri i mbledhjeve të hapura të Komisioneve parlamentare gjatë periudhës korrik-dhjetor 2011

DËGJIMET PUBLIKE

Dëgjimet publike të cilat organizohen nga Komisionet Parlamentare janë mënyra e vetme ku shoqëria civile, grupet e interesit dhe qytetarët ofrojnë kontributin në procesin ligjvënës dhe trajtimin të çështjeve të ndryshme nga ana e komisioneve parlamentare me qëllim që ligjet dhe politikat e ndryshme të bëhen shoqërisht më të pranueshme dhe më lehtë të zbatueshme në praktikë. Në periudhën Korrik-Dhjetor 2011, Komisionet parlamentare kanë organizuar gjithsej 22 dëgjime publike. Në dallim me periudhën Mars-Qershor të të njëjtit vit, për të cilën KDI kishte shprehur shqetësim, numri i dëgjimeve publike të mbajtura në këtë periudhë është rritur për 19 (nëntëmbëdhjetë) më shumë.

Fakti i rritjes së intensitetit të punës së Kuvendit, në këtë rast të organizimit të dëgjimeve publike, fatkeqësisht nuk vë në rezultate një iniciativë të brendshme të Kuvendit, por determinohet nga faktorët tjerë siç është rasti me raportet e institucioneve ndërkombëtare (Raporti i Progresit të Komisionit Evropian). Kjo nuk është mënyra më e mirë për të funksionalizuar parlamentarizmin. Deputetët duhet natyrisht ta njohin rolin e tyre si përfaqësues dhe të jenë më aktiv jo vetëm në organizimin e sa më shumë dëgjimeve publike, por edhe në kryerjen e detyrave tjera që i kërkon jeta parlamentare.

KDI kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, që organizimi i dëgjimeve publike të bëhet për të gjitha Projektligjet, pasi që kjo mundëson pjesëmarrjen më të madhe, qoftë të shoqërisë civile, grupeve të interesit, apo edhe të vet qytetarëve, e që nënkupton pjesëmarrje më të gjerë në vendimmarrje. Pas tjerash, dëgjimet publike nuk nënkuptojnë se domoshmërisht duhet të mbahen në ndërtesën e Parlamentit apo vetëm për ta plotësuar atë si detyrim të cilin e kanë komisionet, por për to duhet zgjedhur edhe vendi i mbajtjes varësisht prej çështjes me të cilën ka të bëjë projektligji. Mbi të gjitha, KDI kërkon që trendi i organizimit të dëgjimeve publike të rritet në të ardhmen, në mënyrë që në tërësi legjislacioni i Kosovës të jetë më cilësor.

MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

Puna dhe energjia e Kuvendit për dhjetë vite, pothuajse në tërësi ka qenë e koncentruar në procesin e ligjvënies dhe zëvendësimit të Rregulloreve dhe akteve tjera administrative të miratuara nga Administrata e UNMIK-ut. Në mungesë të një strategjie për sundimin e ligjit por dhe vullnetit politik, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës, e kanë injoruar procesin e zbatueshmërisë në praktikë të ligjeve të miratuara. Raportet vendore dhe ndërkombëtare me theks të veçantë tri Raportet e fundit të Progresit të Komisionit Evropian kanë konstatuar si një ndër problemet qenësore në Kosovë problemet me sundimin e ligjit, që nënkupton mos zbatimin e ligjeve në praktikë. Po ashtu edhe raporti i fundit i Human Rights Watch (HRW) të publikuar me 22 janar 2012, vlerëson se Kosova gjatë vitit 2011 nuk ka shënuar progres për sa i përket sistemit të drejtësisë. Sipas këtij raporti, ky sistem mbetet i dobët, me gjithë përpjekjet për të ndjekur penalisht individë të dyshuar për korrupsion dhe për krime lufte.

Zbatimi i ligjeve është sfidë jo vetëm për Kuvendin e Kosovës po për të gjitha institucionet kompetente: Qeverinë, institucionet lokale etj.

Kuvendi i Kosovës përkatësisht komisionet parlamentare e kanë të përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit (neni 73) të drejtën dhe detyrën për të mbikëqyrur zbatimin e lig-

jeve në praktikë nga ana e organeve kompetente. Megjithatë këtë të drejtë dhe obligim, komisionet parlamentare nuk po e shfrytëzojnë sa duhet edhe pse tek kjo legjislaturë vërehet një përkushtim më i madh në kryerjen e këtij obligimit përcaktuar me Rregullore të Kuvendit.

Kjo legjislaturë ka arritur që gjatë vitit 2011 të përfundojë monitorimin e 10 Ligjeve, raportet e të cilave janë miratuar në Seanca plenare. Komisionet që kanë përfunduar monitorimin e ligjeve janë: Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticion - Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ligji për liritë fetare Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale - Ligjin për Duhanin; Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri - Ligjin për miniera dhe minerale; Komisioni për Buxhet dhe Financa - Ligji për Financat e Pushtet lokal; Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike - Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës; Komisioni për Pune te Jashtme - ligji për Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik; Komisioni për Punë të Brendshme - Ligjin për Ripranim; Komisioni për Bujqësi - Ligjin për Tokën Bujqësore dhe Komisioni për Legjislacion - Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të konfiskuar.

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Parlamentet e ushtrojnë të drejtën e tyre për të mbikëqyrur ekzekutivin në disa mënyra: përmes pyetjeve parlamentare, interpelancave, nëpërmjet shqyrtimit të raporteve të qeverive mbi punën e tyre; duke ngritur komisione të posaçme për të organizuar vizita në terren me qëllim kontrollit në praktikë të masave të caktuara të qeverisë, mocioneve të votëbesimit etj.

Ndër shqetësimet më të mëdha të artikuluara në raportet vendore dhe ndërkombëtare për punën e Kuvendit të Kosovës edhe më tutje vazhdon të jetë, roli tejet i dobët i mbikëqyrjes - kontrollit parlamentar të Qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës, bazuar në kompetencat kushtetuese sipas parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre.

Duke qenë se koalicioni aktual qeveritar i ka numrat e duhur për ta mbajtur pushtetin, nisimat parlamentare të opozitës në Kuvendin e Kosovës në shumicën e rasteve nuk po arrijnë që të sigurojnë shumicën, kështu që rëndom iniciativat po mbesin vetëm nisma, pa e marrë fuqinë e vendimeve. Kjo ka krijuar perceptimin se Ekzekutivi ose po e dirigjon punën e Kuvendit ose po e shpërfill atë.

Gjithashtu fakti se opozita është mjaft e fragmentarizuar dhe jo unike për shumë çështje, kjo po derivon konkluzionin se kjo legjislaturë nuk po ia del që të ushtrojë kontrollin e plotë mbi Qeverinë, për ta përmbushur kështu detyrimin e vet kushtetues.

INTERPELANCAT PARLAMENTARE

Interpelanca parlamentare si një instrument i kontrollit parlamentar ndaj pushtetit ekzekutiv mundëson që përgjegjësia politike e Qeverisë të jetë më e madhe. Pos tjerash, ky mekanizëm kontrolli ofron mundësinë që nëpërmjet një ndërveprimi të të gjithë deputetëve si dhe përfaqësuesve të qeverisë të kristalizohen çështje me interes të gjerë publik. Deputetët e Kuvendit të Kosovës në këtë legjislaturë, apo gjatë këtij gjashtëmujori të dytë të vitit

2011, e kanë shfrytëzuar shumë pak interpelanca parlamentare për t'i kërkuar qeverisë më shumë llogari.

Ashtu si në gjashtëmujorin e parë edhe në këtë të dytin, nuk ka ndonjë ndryshim të madh sa i përket interpelancave. Edhe në periudhën Korrik-Dhjetor 2011 janë mbajtur dy interpelanca, njëra me 27 Tetor ku i ftuar ishte Kryeministri Hashim Thaçi, si dhe me 07 Dhjetor, ku e ftuar ishte Ministrja Mimoza Kusari-Lila. Kryeministri ishte ftuar për të dhënë llogari në lidhje me situatën politike në pjesën veriore të Kosovës me kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Ndërsa Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë ishte ftuar për të dhënë llogari për sa i përket rikthimit të masave të reciprocitetit me Serbinë. Po ashtu këtë kërkesë e kishte bërë i njëjti subjekt politik. Ndryshe nga herët tjera, sa i përket kësaj të fundit, u miratua mocioni për kthimin e masave të reciprocitetit.

Përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv nuk duhet ta perceptojnë interpelancën në Parlament sikur deputetët gjithnjë e kontestojnë pozicionin e tyre. Përkundrazi, ajo do të duhej të konceptohej si diçka kur çështjet arrijnë të zgjidhen përmes debatit të mirëfilltë. Në kushte të arsyeshme politike thirrja në interpelancë parlamentare e qeveritarëve do të duhej të vinte pse jo edhe nga vetë partia të cilës këta të fundit i takojnë. Të tilla gjëra janë në frymën e funksionalitetit institucional, gjë për të cilën KDI inkurajon deputetët të ndër marrin veprime kësajsoj sa më shpesh.

REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2011

Kuvendi i Kosovës, në prill të këtij viti ka miratuar Planin e vet të punës, në të cilin ka marrë kryesisht për bazë strategjinë legjislative të Qeverisë së Kosovës. Ky plan ambicioz parashihte që deri në fund të vitit 2011, Kuvendi të miratojë gjithsejtë 148 projektligje në leximin të dytë. Ky plan ishte kritikuar, se i tejkalon mundësitë e Kuvendit për të shqyrtuar në mënyrë përmbajtësore një numër kaq të madh të projektligjeve dhe po ashtu Kuvendi do të bllokohej në kryerjen e rolit të vet përfaqësues dhe mbikëqyrës.

Siç edhe pritej planifikimi i një numri kaq të madh të projektligjeve për shqyrtim parlamentar, nuk ka arritur të realizohet as 50%, pasi që Kuvendi në leximin e dytë ka miratuar gjithsejtë 65 projektligje. Gjithashtu Kuvendi ka miratuar edhe 22 projektligje në leximin e parë, e të cilat presin procedurat parlamentare për t'u shqyrtuar dhe aprovuar në sesionin e ri kuvendor. Ky realizim i planit të punës, në dukje të parë është i zbehtë dhe paraqet mos angazhim të duhur të këtij institucioni për të kryer punën e vet, karshi nevojave dhe detyrave që ka Kuvendi përball publikut. Mirëpo është e kundërta, Kuvendi nuk i ka kapacitetet e mjaftueshme për të shqyrtuar një numër kaq të madh të projektligjeve brenda një viti dhe planifikimi i një numri kaq të madh të projektligjeve, kufizon Kuvendin dhe e transformon organin më të lartë përfaqësues në institucion i cili vetëm i voton projektligjet e qeverisë.

Hartimi i programit të punës çalon qysh në momentin e planifikimit, kur Kuvendi përfshin në planin e vet të punës të gjitha projeksionet e Qeverisë dhe më pas, nga volumi i madh i punës dhe angazhimit në komisione, Kuvendi nuk e kryen rolin e vet mbikëqyrës përball Qeverisë dhe institucioneve të tjera për të cilat është i obliguar t'i mbikëqyrë sipas Kushtetutës së vendit.


Problem tjetër në mos përmbushjen e këtij plani të punës, është fakti që pothuajse vetëm Qeveria e Kosovës është sponsoruese e projektligjeve, dhe në këtë formë ajo edhe i dikton dinamikën e punës Kuvendit, duke mos respektuar planifikimet fillestare për afatet e procedimit të këtyre projektligjeve në Kuvend.

Kjo dinamikë e punës dhe ky numër i madh i projektligjeve në procedurë, ka bërë që në Kuvendin e Kosovës, të mos ketë shqyrtime thelbësore dhe substanciale të këtyre projektligjeve, mirëpo ato kryesisht janë shqyrtuar në procedura të ngutshme, si pasojë e mbi ngarkueshmërisë së shumë komisioneve, duke shqyrtuar disa projektligje në të njëjtën kohë. Ato në të shumtën e rasteve janë lekturuar apo korrektuar në teknikën juridike të hartimit të këtyre projektligjeve, mirëpo shumë pak prej tyre kanë patur rastin që të amendamentohen thellësisht dhe të shtohet cilësia e tyre si rezultat i “skanimit parlamentar”.

Kuvendi duhet të sigurojë që në të ardhmen të hartojë planin e punës, në përputhje me mundësitë dhe kapacitetet e veta, administrative dhe politike, në mënyrë që të sigurojë mundësitë e duhura që projektligjet të cilat kalojnë nëpër shqyrtimet e komisioneve, të mund të trajtohen në më shumë dimensione duke përfshirë dhe balancuar edhe interesat e publikut, ekspertëve dhe grupeve të interesit.

Shqyrtimi i projektligjeve pa debate dhe konsultime publike, pa angazhim të ekspertëve, ka ndikuar që një numër shumë i madh i ligjeve të ndryshohen dhe plotësohen nga vitit në vit. Zakonisht gjysma e projeksioneve legislative janë ligje të cilat janë në fuqi, mirë po të cilat janë të pa zbatueshme, dhe të cilat duhet zëvendësuar me të tjera ligje, apo ato duhet plotësuar dhe ndryshuar. Për shembull Ligji për Prokurimin Publik, Ligji për Duhanin, Ligji për Protokollin e Shtetit, Ligji për Grevat, Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi ,etj.

Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit



Tab.2. Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit i paraqitur në përqindje

Në këtë tabelë vërehet se Kuvendi ka miratuar 65 Projektligje në leximin e dytë (apo 44%), ka miratuar vetëm në leximin parë 22 Projektligje (apo 15%) dhe nuk i ka trajtuar fare 61 projektligje të parapara në planin punës (apo 41%).

PARREGULLSITË QË PO E SHOQËROJNË PUNËN E KUVENDIT

Përkundër që një kohë të gjatë KDI po ngrit shqetësim për disa çështje të cilat po pengojnë mbarëvajtjen e punës së Kuvendit të Kosovës si dhe po cenojnë transparencën e tij, organet drejtuese të Kuvendit të Kosovës nuk po ndërmarrin asnjë veprim që këto probleme dhe parregullsi të evitohen.

Parregullsitë e tilla konsistojnë në:

- Mbylljen e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, për monitoruesit e organizatave vendore;
- Mos respektimi i Nenit 12 të Rregullores për përfaqësimin gjinor në trupat e Kuvendit;
- Qasja e vështirësuar në dokumentet zyrtare;
- Përfaqësimi jo i drejtë politik në përbërjen e disa komisioneve parlamentare;
- Votimi në mbledhjet e komisioneve nuk bëhet në përputhje me format e parapara në Rregulloren e punës. “Votimi me konsensus” edhe pse ka përmirësime, si i tillë është thyerje e të drejtës për t’u deklaruar me votë për secilin anëtar në komision;
- Publikimi me shumë vonesë i votimit elektronik, për seancat plenare;
- Komisionet parlamentare dhe Kryesia nuk mbajnë transkripte të punës, apo nuk i publikojnë fare ato;
- Kryesia dhe disa komisione parlamentare, nuk publikojnë procesverbale;
- Publikimi me vonesë i transkripteve, procesverbaleve dhe informatave për punën e Kuvendit dhe trupave të tij.

**REZULTATET E NOTIMEVE PËR DEPUTETËT E KUVENDIT TË KOSOVËS
PËR PERIUDHËN KORRIK - DHJETOR 2011**

Kuvendi i Kosovës				Pjesëmarrja në diskutime	Diskutimet në emër të gr. parl. apo Komisionit	Ngritja e çështjeve apo propozimeve	Ngritja e çështjeve urgjente	Propozimet për amendamente	Nisma ligjore	Kërkesa për interpelancë	Pyesjet parlamentare	Mungesat në seanca	Totali
Nr	Deputetët	Subjekti politik	4 pikë	2 pikë	5 pikë	9 pikë	3 pikë	10 pikë	8 pikë	5 pikë	-1 pikë	%	
GRUPI PARLAMENTAR PDK													
1	ADEM GRABOVCI	PDK	8	36	5	9	0	0	0	0	0	-2	1.15%
2	ARSIM BAJRAMI	PDK	56	8	10	0	0	0	0	0	0	-3	1.46%
3	AZEM SYLA	PDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-14	-0.29%
4	BEHAR SELIMI	PDK	8	10	0	0	0	0	0	0	0	-3	0.31%
5	BEKIM HAXHIU	PDK	80	2	20	0	18	0	0	10	0	-1	2.66%
6	BERAT BUZHALA	PDK	12	8	0	0	0	0	0	0	0	-2	0.37%
7	BLERTA DELIU-KODRA	PDK	24	6	5	0	0	0	0	0	0	-2	0.68%
8	ELMI REÇICA	PDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-1	-0.02%
9	FADIL DEMAKU	PDK	20	2	15	0	0	0	0	5	-2	0.82%	
10	FATMIR LIMAJ	PDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-22	-0.45%
11	FATMIR XHELILI	PDK	4	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0.70%
12	FLORA BROVINA	PDK	16	4	5	0	0	0	0	0	0	-2	0.47%
13	GANIMETE MUSLIU	PDK	40	6	10	0	0	0	0	0	0	0	1.15%
14	HALIT KRASNIQI	PDK	28	6	10	0	0	0	0	0	0	-3	0.85%
15	HASIME KRASNIQI	PDK	8	18	5	0	0	0	0	0	0	-2	0.60%
16	HYDAJET HYSINI	PDK	68	4	15	0	0	0	0	0	0	0	1.79%
17	IDRIZ VEHAJI	PDK	20	32	5	0	0	0	0	0	0	-2	1.13%
18	JAKUP KRASNIQI	PDK	24	0	10	0	0	0	0	0	0	-1	0.68%
19	JUSTINA PULA	PDK	20	6	15	0	0	0	0	0	0	-4	0.76%
20	KURTAN KAJTAZI	PDK	12	4	10	0	0	0	0	5	-5	0.54%	
21	LATIF GASHI	PDK	4	2	5	0	0	0	0	0	0	0	0.23%
22	LUMNIJE MORINA	PDK	8	0	5	0	0	0	0	0	0	-1	0.25%
23	NAHIT HASANI	PDK	16	32	10	0	0	0	0	0	0	-1	1.18%
24	NIJAZI IDRIZI	PDK	20	22	0	0	3	0	0	10	-1	1.11%	
25	RAMË VATAJ	PDK	20	10	5	0	3	0	0	0	0	0	0.78%
26	RAMIZ LLADROVCI	PDK	40	8	20	0	0	0	0	0	0	-2	1.36%
27	SAFETE HADERGJONAJ	PDK	20	56	5	0	0	0	0	5	0	0	1.77%
28	SALA BERISHA – SHALA	PDK	20	8	0	0	0	0	0	5	0	0	0.68%
29	SALIHE MUSTAFA	PDK	8	8	0	0	0	0	0	10	0	0	0.54%
30	SHAIP MUJA	PDK	64	2	15	0	0	0	0	10	-2	1.83%	
31	VALBONA DIBRA	PDK	28	6	15	0	0	0	0	0	0	-2	0.97%
32	XHAVIT HALITI	PDK	12	0	5	0	0	0	0	0	0	-6	0.23%
33	XHEVAHIRE IZMAKU	PDK	20	12	5	0	0	0	0	0	0	-3	0.70%
34	ZENUN PAJAZITI	PDK	56	42	10	0	0	0	0	0	0	-2	2.19%
GRUPI PARLAMENTAR LDK													
1	AFERDITA BERISHA – SHAQIRI	LDK	20	6	25	0	0	0	0	10	0	0	1.26%
2	ALI SADRIU	LDK	20	12	10	0	0	0	0	0	0	-5	0.76%
3	ANTON QUNI	LDK	16	20	5	0	0	0	0	0	0	-1	0.82%
4	ARBEN GASHI	LDK	24	66	15	0	0	0	0	0	0	-5	2.06%
5	ARMEND ZEMAJ	LDK	60	24	25	0	0	0	0	5	-1	2.33%	
6	BAHRI THAÇI	LDK	8	4	10	0	0	0	0	0	0	-1	0.43%
7	EQREM KRYEZIU	LDK	4	2	0	0	0	0	0	0	0	-4	0.04%
8	HAKI DEMOLLI	LDK	44	6	25	0	0	0	0	5	-4	1.57%	
9	HASHIM DESHISHKU	LDK	16	4	20	0	0	0	0	5	-3	0.87%	
10	HYKMETE BAJRAMI	LDK	8	8	5	0	0	0	0	10	-2	0.60%	
11	IMRI AHMETI	LDK	0	2	0	0	0	0	0	10	-5	0.14%	
12	ISMET BEQIRI	LDK	24	34	10	0	0	0	0	0	0	0	1.40%
13	LIRIJE KAJTAZI	LDK	8	4	10	0	0	0	0	5	-2	0.52%	
14	LUTFI HAZIRI	LDK	44	8	10	0	0	0	0	10	-4	1.40%	
15	LUTFI ZHARKU	LDK	0	6	0	0	0	0	0	0	0	-2	0.08%
16	NASER OSMANI	LDK	24	22	5	0	0	0	0	0	0	-1	1.03%
17	NAZANE BRECA	LDK	12	2	10	0	0	0	0	15	-1	0.78%	
18	KIMETE BYTYCI	LDK	8	0	10	0	0	0	0	5	-2	0.43%	
19	RITA HAJZERAJ – BEQAJ	LDK	16	4	15	0	0	0	0	10	-4	0.85%	
20	SABRI HAMITI	LDK	112	2	35	0	3	0	0	0	0	-2	3.09%
21	SADRI FERATI	LDK	28	12	15	0	0	0	0	0	0	0	1.13%
22	SALI ASLLANAJ	LDK	20	2	10	0	6	0	0	5	-1	0.87%	
23	SALIH MORINA	LDK	24	18	20	0	0	0	0	10	-1	1.46%	
24	SKENDER HYSINI	LDK	8	0	5	0	0	0	0	0	0	-1	0.25%
25	TEUTA SAHATQIJA	LDK	44	10	10	0	3	0	0	0	0	-3	1.32%
26	VJOLLCA KRASNIQI	LDK	8	10	5	0	0	0	0	0	0	-1	0.45%
27	VJOSA OSMANI	LDK	16	6	15	0	0	0	0	0	0	-8	0.60%

Kuvendi i Kosovës				Pjesëmarrja në diskutime	Diskutimet në emër të gr. pari. apo Komisionit	Ngritja e çështjeve apo propozimeve	Ngritja e çështjeve urgjente	Propozimet për amendamente	Nisma ligjore	Kërkesa për interpelancë	Pyetjet parlamentare	Mungesat në seanca	Totali
Nr	Deputetët	Subjekti politik	4 pikë	2 pikë	5 pikë	9 pikë	3 pikë	10 pikë	8 pikë	5 pikë	-1 pikë	%	
G.P. VETVENDOSJE													
1	AFRIM HOTI	VV	4	6	0	0	0	0	0	0	0	-4	0.12%
2	ALBANA FETOSHI	VV	4	4	5	0	0	0	0	0	0	-2	0.23%
3	ALBANA GASHI	VV	4	12	5	0	6	0	0	0	0	-3	0.49%
4	ALBIN KURTI	VV	16	10	5	0	0	0	0	0	0	-7	0.49%
5	ALBULENA HAXHIU	VV	8	28	5	0	0	0	0	5	-4	0.87%	
6	ALMA LAMA	VV	48	12	5	0	0	0	0	25	-5	1.75%	
7	AFRIM KASOLLI	VV	16	16	5	0	0	0	0	10	-2	0.93%	
8	FLORIN KRASNIQI	VV	16	2	10	0	0	0	0	0	0	-8	0.41%
9	GLAUK KONJUFCA	VV	48	12	20	0	0	0	0	5	-1	1.73%	
10	LIBURN ALIU	VV	24	38	10	0	0	0	0	20	-1	1.88%	
11	REXHEP SELIMI	VV	40	30	20	0	0	0	0	0	0	-1	1.83%
12	VISAR YMERI	VV	40	52	20	0	0	0	0	30	-2	2.89%	
G.P. AAK													
1	AHMET ISUFI	AAK	20	24	5	0	0	0	0	0	0	-2	0.97%
2	ARDIAN GJINI	AAK	68	54	25	0	0	0	0	0	0	-2	2.99%
3	BALI MUHAREMAJ	AAK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	-4	0.08%
4	BLERIM SHALA	AAK	16	4	10	0	0	0	0	0	0	-1	0.60%
5	BURIM RAMADANI	AAK	28	24	5	0	0	0	0	0	0	-3	1.11%
6	DAUT HARADINAJ	AAK	0	2	0	0	0	0	0	0	0	-7	-0.10%
7	DONIKA KADAJ – BUJUPI	AAK	28	14	5	0	0	0	0	10	-3	1.11%	
8	KYMETE BAJRAKTARI	AAK	4	6	5	0	0	0	0	0	0	0	0.31%
9	RAMIZ KEMENDI	AAK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-7	-0.14%
10	TEUTA HAXHIU	AAK	28	22	25	0	0	0	0	0	0	0	1.55%
11	XHEVDET NEZIRAJ	AAK	20	14	15	0	0	0	0	10	0	0	1.22%
12	TIME KADRIJAJ	AAK	24	28	10	0	0	0	0	25	-1	1.77%	
G.P. SLS													
1	MILIVOJE STOJANOVIC	SLS	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0.04%
2	JELENA BONTIC	SLS	0	8	0	0	0	0	0	0	0	-4	0.08%
3	PETAR MILETIC	SLS	4	6	0	0	0	0	0	0	0	-4	0.12%
4	JASMINA ZIVKOVIC	SLS	0	6	0	0	0	0	0	0	0	-4	0.04%
5	SASA MILOSAVLJEVIC	SLS	0	56	0	0	0	0	0	0	0	-1	1.13%
6	BISERKA KOSTIC	SLS	0	14	0	0	0	0	0	0	0	-3	0.23%
7	ETEM ATIFI	SLS	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-3	-0.06%
8	SASA ĐOKIC	SLS	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
9	GORAN MARINKOVIC	SLS	12	8	10	0	0	0	0	0	0	-2	0.58%
10	BOBAN TODOROVIC	SLS	0	6	0	0	0	0	0	0	0	-1	0.10%
11	MURSELJ HALJILJI	SLS	4	2	0	0	0	0	0	0	0	-3	0.06%
G.P. KKR													
1	AMIR AHMETI	KKR	20	8	10	0	0	0	0	0	0	-3	0.72%
2	GEZIM KEMENDI	KKR	28	16	15	0	0	0	0	0	0	0	1.22%
3	EMIN GERBESHI	KKR	16	4	0	0	0	0	0	0	0	-2	0.37%
4	JETON SVIRCA	KKR	16	10	5	0	0	0	0	0	0	-4	0.56%
5	MUHAMET MUSTAFA	KKR	40	20	15	0	0	0	0	0	0	-1	1.53%
6	MYZEJENE SELMANI	KKR	16	78	5	0	0	0	0	0	0	0	2.04%
7	SEVDIJE LAMA	KKR	0	24	0	0	0	0	0	0	0	-1	0.47%
8	SUZAN NOVBRDALIU	KKR	12	38	10	0	0	0	0	0	0	-3	1.18%
9	UKË RUGOVA	KKR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-5	-0.10%
G.P. 6+													
1	RASIM DEMIRI	6+	8	34	0	0	0	0	0	0	0	-1	0.85%
2	ENIS KERVAN	6+	12	10	5	0	0	0	0	0	0	-4	0.47%
3	DUDA BALJE	6+	24	36	15	0	0	0	0	10	-1	1.73%	
4	ALBERT KINOLLI	6+	4	38	5	0	0	0	0	0	0	-5	0.87%
5	MUFERA SINIK	6+	4	6	5	0	0	0	0	0	0	-4	0.23%
6	FIKRIM DAMKA	6+	8	14	5	0	0	0	0	0	0	-3	0.49%
PA GRUP													
1	AURORA BAKALLI		24	2	20	0	0	0	0	10	-2	1.11%	
2	AGIM KULETA		32	0	15	0	0	0	0	10	-1	1.15%	
3	HAMZA BALJE		16	0	10	0	0	0	0	0	-1	0.52%	
4	VESIMIR SAVIC		4	0	0	0	0	0	0	0	-1	0.06%	
5	VESNA MIKIC		8	0	10	0	0	0	0	0	0	0.37%	
6	EMILIJA REDZEPI		44	0	20	0	0	0	0	0	-2	1.28%	
7	RADA TRAJKOVIC		0	0	0	0	0	0	0	0	-9	-0.19%	
8	SRETEN IVANOVIC		0	0	0	0	0	0	0	0	-5	-0.10%	
9	DANUSH ADEMI		4	0	0	0	0	0	0	0	-3	0.02%	

REZULTATET E NOTIMEVE PËR SUBJEKTE POLITIKE

Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në diskutime	Diskutimet në emër të gr. parl. apo Komisionit	Ngritja e çështjeve apo propozimeve	Ngritja e çështjeve urgjente	Propozimet për amendamente	Nisma ligjore	Kërkesa për interpelancë	Pyetjet parlamentare	Mungesat në seanca	Totali
Nr	Subjekte politike	Numri i anëtarëve										
1	PDK	34	784	390	240	9	24	0	0	60	-91	29.19%
2	LDK	27	616	294	325	0	12	0	0	105	-64	26.55%
3	LVV	12	268	222	110	0	6	0	20	95	-40	13.63%
4	AAK	12	236	200	105	0	0	0	0	45	-30	11.46%
5	SLS	11	20	108	10	0	0	0	0	0	-25	2.33%
6	KKR	9	148	198	60	0	0	0	0	0	-19	7.98%
7	6+	6	60	138	35	0	0	0	0	10	-18	4.64%
8	Pa grup	9	132	2	75	0	0	0	0	20	-24	4.23%

ANALIZA KRAHASUESE E DEPUTETËVE

Deputetët më aktiv gjatë kësaj periudhe parlamentare

1. SABRI HAMITI 3.09%
2. ARDIAN GJINI 2.99%
3. VISAR YMERI 2.89%
4. BEKIM HAXHIU 2.66%
5. ARMEND ZEMAJ 2.33%

Deputetët me pasiv gjatë kësaj periudhe parlamentare

- FATMIR LIMAJ -0.45%
- 1. AZEM SYLA -0.29%
- 2. RADA TRAJKOVIC -0.19%
- 3. RAMIZ KELMENDI -0.14%
- 4. DAUT HARADINAJ -0.10%
- 5. UKË RUGOVA -0.10%

The opinions expressed herein are those of the author. This publication was made possible through support provided by:
Mendimet e shprehura në tekst janë të autorit. Ky publikim është bërë i mundur nga përkrahja e ofruar prej:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world